

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale për veprat ujore”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**4410000-1**

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,451,150(*dy milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë*) lekë pa tvsh

2,941,380 (*dy milion e nëntëqind e dyzet e një mijë e treqind e tetëdhjetë*) lekë me tvsh

Vlera e fondit limit është përlllogaritur bazuar në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Kreu VI “rregulla të përgjithshme dhe përgatitja e procesit të prokurimit”, neni 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, Vendimit nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 12 “Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës”. Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit i ngritur me Urdher Titullari nr.46 prot date 30.01.2026 pasi ka bërë një studim të tregut ka gjetur oferta nga operatore ekonomike që operojnë në këto fushë dhe ka llogaritur mesataren e cmimit të tregut duke nxjerrë dhe fondin limit për procedurën.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Maliq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, neni 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, neni 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet **2023-2024-2025** të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve ,2023,2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për ”Procedurës Tatimore ”neni 64 Deklarata Tatimore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se

operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten

Kriteret e kërkuara në pikën 2.2.1 dhe 2.2.2. janë vendosur me qëllim që të vërtëtohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetet për vitin 2026 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

Argumentimi sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, Pasi cdo operator ekonomik duhet të ketë të paguara taksat dhe tarifatat vendore prane njësive të qeverisjes vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit të kontratës ,ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% i fondit limit të kesaj kontrate

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumatat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumatat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e

mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit se do të garantojë dorezimin e mallin sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda 30 ditëve nga data e kërkesës së Autoritetit Kontraktor

Argumentim: Në bazë të të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 85, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri Autoriteti Kontraktor siguron se do të furnizohet me mallrat e kërkuar brenda afatit të kontrates.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin e vetedeklarimit se ka 1(nje) kamion me vinç me kapacitet mbajtes sipas lejes se qarkullimit nga 5-10 ton ,

(Shenim per kapacitetin mbajtes se mjeteve te kerkuara per realizimin e punimeve.Kapaciteti mbajtes i mjeteve sipas lejes se qarkullimit do llogaritet nga diferenca midis Mases maksimale me ngarkese te plote te lejuar ne Shqiperi dhe Mases se mjetit bosh.)

“Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimimit autoriteti kontraktor I kerkon ofertuesit I kualifikuar I pari ,dorezimin e dokumentave provuese si dhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuar ne menyre elektronike si me poshte:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme
5. Certificate per lejetransportiteleshuarnga Bashkia

dhe permjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]
6. Certificate per lejetransportiteleshuarnga Bashkia

Ne rastin e mjeteve te marra me qera nga operatorët ekonomike bazuar ne njoftimin e APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit(leje qarkullimi,certificate e transportit te mallrave) ,mjetet nuk duhet te rezultojne per perdorim vetjak por per perdorim nga te tretet.

b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten :

per mjetet ne pronesi :

- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

permjetet me qera :

- të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.
- aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

c) Deklarate nga Operatori ekonomik për makineritë e mësipërme të cilat nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Keto mjete janë të nevojshme për të bërë transportin e materialeve sipas kërkesës së autoritetit kontraktor. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Është kërkuar 1(nje) kamion me vinç me kapacitet mbajtës sipas lejes së qarkullimit nga 5-10 ton ,duke marrë parasysh dhe natyrën dhe sasinë e mallrave që do të transportohet sipas kërkesës së autoritetit kontraktor në destinacion.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë në formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 ,një punësim mesatar i të paktën 3 (tre) punonjësve për muajin e fundit.

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

- a. **Vërtetim** të lëshuar dhe konfirmuar (*me firmë dhe vule*) nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.
Dhe
- b. **Listpagesat** e konfirmuar (*me firmë dhe vule*) nga Administrata Tatimore të punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në formularin e vetëdeklarimit se ka të punësuar, minimalisht 3(tre) punonjës si më poshtë:

- Shofer kamioni (1)

“Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

Kur mjetet janë në pronësi

1. *kontrata e punës (e vlefshme)*
2. *Certifikate Aftësie Profesionale të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor*
3. *Leje Drejtimi kategoria C*

Kur mjetet janë me qera

Deklarate nga operatori ekonomik, qe ne rastin e shpalljes fitues, do paraqese kontrate pune me shoferin(i cili duhet te kete Certifikate Aftësie Profesionale të leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor dhe Leje Drejtimi kategoria C) deri ne perfundimin e afateve te kontrates

- Punetore te thjeshte (2)

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

1. kontrata e punës e vlefshme;

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Jane kerkuar minimalisht 3 punonjës,1 shofer per mjetin kamion dhe 2 punonjes te thjeshte te cilet jane te nevojshem per transportin dhe shkarkimin e mallrave ne destinacionin e kerkuar.